



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-222970 • E-mail: [filologjia@uni-pr.edu](mailto:filologjia@uni-pr.edu) • [www.filologjia.uni-pr.edu](http://www.filologjia.uni-pr.edu)

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë

Nr. prot.: 01/4629

Datë: 11/10/2023

Mbështetur në nenin 76 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, dt. 12.10.2012, Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me Nr. prot. 01/95, dt.24.06.2021, Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e mbajtur më 11.10.2023, mori

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar Ankesa me nr. prot. 03/4379, datë 02.10.2023 e kandidates MA Valë Rudari kundër Vendimit me Nr. Prot.: 01/426 të datës, 28.09.2023 për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në programet e Fakultetit të Filologjisë.
- II. **MIRATOHET** Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në lidhje me Konkursin e dt. 1.8.2023, në nivel të Fakultetit me Nr, Prot.: 03/4513, dt. 9.10.2023 duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr. prot. 01/95, dt.24.06.2021, në neni 7, pika 3.2 e paragrafit 3 parasheh që kushtet që kandidatët duhet të kenë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit; pika 4.1 e nenit 7 sqaron çështjen e përvojës së respektivisht: përvojë e punës në fushën përkatëse konsiderohet angazhimi në UP ose në ndonjë institucion të akredituar të arsimit të lartë.
- III. Mbeten në fuqi Raporti me Nr. Prot.: 03/4068 (pozita III.17 për ushtrime për lëndët: Mediet e reja dhe portalet, Media dhe e drejta, Teori dhe praktikë e Marrëdhënieve me Publikun, Gazetari sportive); Raporti me Nr. Prot.: 03/4070 (Pozita III.21. për ligjëratat për lëndën: Diksion); Raporti me Nr. Prot.: 03/4073 (Pozita III.22 për ushtrime për lëndë: Diksion) të dt. 22.09.2023 i komisionit për angazhimin e një bashkëpunëtori të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve për pozitat III.17 dhe III.22 si dhe për ligjerta për pozitën III.21.

## Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen e mbajtur më 11.10.2023, ka shqyrtuar Raportin me Nr, Prot.: 03/4513, dt. 9.10.2023 të komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të pakënaqur lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në programet e Fakultetit të Filologjisë, sipas Konkursit me me Nr. prot. 1/909, datë 1.8.2023, të Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Duke marrë parasysh atë çfarë u tha më lart, u vendos si në dispozitiv.

Vendimi t'u dërgohet:

- Arkivit të fakultetit
- Komisioneve vlerësuese
- Prodekanit për mësimdhënie dhe çështje për studentë
- Departamenteve përkatëse
- Zyrës për TI (për publikim në uebfaqe)

